



countering violent extremism

Partizanski Odredi 106 1/3, Skopje

02/6159832

info@zipinstitute.mk

www.zipinstitute.mk



30, mars, 2017

Vizitë në kampin e migrantëve në Gjevgjeli

Në fund të muajit mars, në bazë të projektit CVE, timi I Institutit ZIP pati mundësinë të vizitojë Qendrën për tranzicion dhe kampin për Refugjatët Vinojug në afërsi të Gjevgjelisë. Gjatë vizitës sonë, përveç asaj që patëm mundësi për lëvizje të lirshme në kamp dhe të shohim kapacitetet për strehim, kuzhinën, kanalizimin dhe kushtet e jetesës dhe të punës, kemi pasur mundësi për së afërmi të njihemi me 14 refugjatët që aktualisht jetojnë në Vinojug . Gjithashtu, na u dha mundësia të flasim edhe me personat të cilët ju ndihmojnë dhe punojnë në këtë qendër.

Qendra për tranzicion është një qytet brenda një qyteti. Sipërfaqe e rrethuar nga një gardh i lartë me tela me gjemba. Edhe pse kriza e migrantëve apo refugjatëve në vend u përshkrua si e stuhishme, ekipi ynë hasi në një situatë krejtësisht ndryshe gjatë vizitës tone në Qendrën e tranzicionit dhe kampit të refugjatëve Vinojug. Aktualisht, aty jetojnë vetëm 14 refugjatë.

Në hyrje të qendrës u regjistruam në zyrat e Ministrisë së Punëve të Brendshme, ku i paraqitëm lejet për vizitë të miratura nga Qendra për Menxhim me Kriza si dhe lejet për fotografi nga vet Ministria.

Duke ecur në këtë qendër, arritëm në zyrën e Kryqit të Kuq. Dhe në fakt atje u takuam me Slobodan Mitroviq, kreu i ekipit të Kryqit të Kuq në Vinojug, me të cilin kishim mundësinë për të folur në lidhje me punën e tij, sfidat me të cilat vullnetarët përballen çdo ditë, si dhe për temat kyçe dhe aspektet e krizës së refugjatëve të cilat ishin më të ekspozuara në media. Për më shumë informata , do të mundet të lexoni javën e ardhshme (një intervistë shumë interesante!).

Së bashku me Slobodanin, ecëm në Qendrën dhe u takuam me vullnetarë tjerë, si dhe me disa nga personat që janë në tranzicion, apo që jetojnë këtu. Numri i vullnetarëve dhe stafit në Vinojug është i zvogëluar. Shumë refugjatë dhe emigrantë kanë kaluar tranzit në vendet perëndimore, ose me kërkesa personale janë kthyer në Greqi.

Kushtet e jetesës në qendër janë të mira në qoftë se kushtet e jetesës në qendër tranziti dhe kampin e refugjatëve mund të quhen si të tilla. Ka strehimore të mjaftueshme, vende për edukim dhe arsimim për fëmijët, tualete dhe kanalizim, kuzhina dhe dhoma ngrënie dhe objekte fetare.

Në kuzhinë, biseduam me vullnetarë të cilët kujdesen për këta persona që të marrin ushqim tre herë në ditë. Ata na thanë se si rezultat i zvogëlimit të numrit të refugjatëve dhe emigrantëve, shpesh gatuajnë sipas dëshirave të njerëzve që jetojnë këtu. Janë blerë edhe ushqime rajonale dhe erëza për të sjellë ndjenjën e gatesave të shtëpisë. Gjërat e këtilla edhe pse duken të vogla, sjellin gëzim për këta njerëz.

Nevojat mjekësore, që nga hapja e Qendrës deri më tani, janë plotësuar gjithmonë në kohë. Gjendja shëndetësore e personave që kanë tranzituar, dhe që aktualisht jetojnë këtu është e mirë. Në këndin e fëmijëve u komentua se nuk ka pasur ndonjë epidemi tek fëmijët, si dukuri shumë të zakonshme në institucione të tilla, dmth kampe dhe qendra tranziti.

Duke folur me vullnetarët e UNICEF-it në këndin e fëmijëve, mësuam pak më shumë për gjendjen e fëmijëve në qendër. Konfliktet dhe i gjithë procesi i tranzitimit ka ndikimi më të madh në to dhe shpesh herë traumat lënë pasojë afatgjatë. Megjithatë, qasja e vullnetarëve është e individualizuar, dhe me sa pamë, ata janë të lidhur ngushtë me secilin fëmijë dhe mundohen ti përfshijnë në të gjitha aktivitetet. Fëmijët ishin me të vërtetë kurioz për t'u njoftuar me ne, kështu që kaluam edhe pak kohë duke luajtur me ta. Vajzat nga UNICEF-i na treguan në lidhje me mënyrat e ndryshme të edukimit, përfshirjes sociale të fëmijëve dhe disa shaka dhe anekdota nga puna e tyre. Përshtypje na la historia e Ivanit, fëmijës së lindur në Qendrën. „ Ne kishim shumë Ivan-a, vullnetare të quajtura Ivana andaj vendosën ta emërtojnë ashtu! " duke buzëqeshur tregoi vullnetari.

Përshtypja na la vajza me emrin Rano e cila kishte vetëm 4 vjet, prindërit e së cilis kishin ndruar jetë në Siri ndërsa ne Qendër kishte arritur me tezen e saj. Ajo aktualisht është e vetme në Vinojug sepse familjarët ishin kthyer në Greqi, dhe për shkak se ajo nuk e ka kujdestarin e saj, nuk i është lejuar ta kalon kufirin me mbesën e saj. Tani për Ranon kujdesen vullnetarët në kamp, dhe ka gjasa të transferohet në një prej shtëpive të sigurta në Shkup, nën kujdestari të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale. Edhe pse për shkak të pengesës së gjuhës nuk komunikua me të , buzëqeshja e saj nuk mungoi asesi.

Edhe pse ndjenja e pasigurisë dhe frikës ishte e pranishme që nga hapat e para në hyrje të kampit, me hapin e fundit ajo pasiguria në njëfarë mënyre u shfaq ne lloj shtrëngimi. Njerëz të izoluar, në tokë të huaj, me qëllim të gjejnë një vendbanim më të mirë.

Zakonisht qytetet e mëdha konsiderohen si vende që lejojnë njerëzit të ëndërrojnë për qëllime apo dëshirat të mëdha. Megjithatë, dëshirat dhe ëndërrat më të mëdha dhe më të sinqerta, dëshirat apo ëndërrat për një jetë më të mirë, kushte themelore, siguri dhe respekt për të drejtat themelore njerëzore, ëndërrohen në këto Qendra tranzicioni dhe kampe të refugjatëve.



Përgaditur nga: Jovana Perovska dhe Maida Ameti

